



Fshati Prush, Komuna Vaqarr, Tirane-Albania
Tel: +355(044)803370
E: info@helpthelife.org.al
W: www.helpthelife.org

Termat e Referencës

*Njoftim për Ekspert/Kompani për të realizuar një video të shkurtër
për promovimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për fëmijët me aftësi të kufizuara*

Organizata:	Shoqata Ndihmoni Jetën Fshati Prush, Njesia Administrative Vaqarr, Tirane Tel: +355(044)803370 Web site: www.helpthelife.org ; E-mail: info@helpthelife.org.al
Projekti:	“Mbështetja në moshë të hershme, një mundësi për zhvillimin e fëmijës”
Koha e angazhimit	20 Dhjetor 2021 – 20 Prill 2022
Donor	Bashkia Lezhë në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD)

Prezantimi

Shoqata “Ndihmoni Jetën” është organizatë Kombëtare jo-fitimprurëse, e ngritur në Tiranë në Shtator 1998, si një iniciativë e një grupi prindërisht të fëmijëve me aftësi të kufizuara me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe gjithëpërfshirjen e personave me AK në shoqëri.

Shoqata ka një eksperiencë dhe ekspertizë të ngritur që prej operimit të saj në fushën e trajtimit psiko-socio-edukative të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara, duke ofruar Modele të trajnimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara me një ekip multidisiplinar. Referuar kësaj ekspertize, Shoqata ka fokusuar punën e saj në rritjen e kapaciteteve të specialistëve që punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet e edukimit parashkollor (çerdhe/kopështe), shkollë, shërbime rehabilituese në qendër komunitare/qendra ditore, mbështetje në familje, ngritjen e vetdijes dhe informacionit të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe anëtarëve të tjerë të familjes dhe komunitetit, si dhe advokaci dhe lobimin për respektimin e të drejtave të këtij target grupi në zbatim të Konventës për të Drejtat e Personave me AK.

Shoqata, me mbështetjen e ‘Bashkia Lezhë në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), ka filluar implementimin e Projektit “Mbështetja në moshë të hershme, një mundësi për zhvillimin e fëmijës”, i cili implementohet në qytetin e Lezhës.

Projekti është dizenuar tju vij në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe ata me vështirësi në zhvillim që ndjekin Institucionet e edukimit të hershëm në qytetin e Lezhës. Kjo gjë do të arrihet duke trajnuar edukatorët e institucioneve të edukimit të hershëm, si dhe stafit mbështetës që punon për zhvillimin e fëmijëve me vështirësi në zhvillim në këto institucione dhe prindërit e tyre. Gjithashtu, projekti do të ngrej Rrjetin lokal të Institucioneve publike dhe private që punojnë me/për fëmijët me aftësi të kufizuara, në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë Lezhë duke u fokusuar në ngritjen e kapaciteteve të tyre në drejtim të fëmijëve me AK.

Objektivat kryesore dhe rezultatet e projektit janë:

Objektivi i Përgjithshëm:

Të përmiresojmë kapacitetet e fëmijëve me vështirësi në zhvillim në drejtim të zhvillimit mendor, social dhe edukativ, dhe ti ndihmojmë ata të kenë një jetë të pavarur dhe gjithëpërfshirëse në komunitet.

Objektivat Specifikë:

OS.1. Të rris kapacitetet e prindërve të fëmijëve me vështirësi në zhvillim dhe punonjësve të edukimit të hershem të identifikojnë dhe mbështesin zhvillimin e fëmijëve me vështirësi në zhvillim, dhe rrisin aksesin në shërbime cilësore.

OS.2 Të rritet niveli i ndërgjegjësimit të institucioneve (shëndetësore, arsimore, punësimit, ofrues shërbimi, etj) në nivel lokal dhe anetare të tjera të komunitetit në bashkinë Lezhë për të adresuar më mirë nevojat e PAK.

Në kuadër të implementimit të këtij projekti, Shoqata “Ndhmoni Jetën” kërkon të kontraktoj një ekspert apo kompani, të aftë për të demonstruar aftësi humane, etike dhe teknike dhe për të realizuar një video promovuese dhe ndërgjegjësuere për projektin e mësipërm.

Qëllimi i shërbimit:

Ndhmoni Jetën kërkon të realizoj një video promovuese për të ndërgjegjësuar komunitetin mbi programin e Ndërhijës së Hershme dhe informuar prindërit mbi rëndësinë e identifikimit, referimit tek specialisti i fushës dhe trajtimit të fëmijëve të tyre me aftësi të kufizuara që në moshë të hershme duke ndihmuar në zhvillimin e kapaciteteve të tyre sa më të shpejt. Po ashtu në këtë video të preaanktohet edhe roli i printit dhe edukatorit si elementet kyçe në zhvillimin e fëmijës. Video do të prodhohet sipas skenarit që do të përgatitet nga stafi i projektit dhe do të diskutohet me ekspertin.

Detyrat që pritet të realizohen nga Eksperti/Agjensia:

Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Koordinatorës të Projektit dhe ekspertit të fushës pranë Shoqatës, individët / agjencia pritet të:

- Përcaktoj një plan kohor që tregon kohën e nevojshme për përgatitjen, xhirimin, redaktimin dhe finalizimin e videos;
- Shembuj të punimeve të mëparshme gjithashtu duhet të dorëzohen;
- Zhvillimi i procedurave të përshtatshme për redaktimin dhe finalizimin e pamjeve të përgjithshme në versionin përfundimtar të titruar.

Përgjegjësitë e Ndhmoni Jetën

- Të sigurojë të gjitha materialet e kërkuara në kohën e duhur;
- Identifikoj saktë skenarin e videos dhe qëllimin e saj si dhe të siguroj ndarjen e saj në mënyrë sa më të qartë me ekspertin;
- Lehtësimi i bërjes së videos në zonat ku implementohet projekti,
- Mbikëqyrje ofruesin e shërbimeve duke menaxhuar kontratën e konsulencës;
- Monitoron respektimin e afateve të përcaktuara;
- lehtësimi për dhënien e informacionit të kërkuar;
- Ofrimi i udhëzimeve në të gjitha fazat e ekzekutimit, miratimi i të gjitha rezultateve dhe lehtësimi i hedhjes së videos në faqen e projektit dhe ndërhijet.

Vendi i konsulencës: Tiranë dhe Lezhë

Kohëzgjatja e konsulencës: 20 Dhjetor 2021 – 20 Prill 2022

Politikat e mbrojtjes së fëmijëve të Ndihamoni Jetën:

Personat që do të punojnë me Kontrata Shërbimi për Ndihamoni Jetën duhet të pranojnë me shkrim se ata kanë kuptuar “Politikën e Ndihamoni Jetën për Mbrojtjen e Fëmijëve” dhe standartet që përcakton kjo politikë.

Produkti

Kompania/eksperti pritët të dorëzojë tek Shoqata Ndihamoni Jetën një video me kohëzgjatje 30’’-1’ jo më vonë se data 11 Maj 2022, date që perkon me përfundimin e projektit.

Rezultatet kryesore të detyrës do të jenë:

- Hartimi i draftit të historisë për komentet dhe kontributet e ekipit të projektit,
- Drafti i parë i videos,
- Dorëzimi i draftit përfundimtar të videos,
- Dorëzimi përfundimtar i videos deri më 11 Maj 2022.

SPECIFIKIMET E TJERA: Video do të jetë në gjuhën shqipe dhe me titra në gjuhën shqipe dhe paraqitja e saj duhet të jetë në përputhje me Udhëzimet e ReLOaD për vizibilitetin dhe duhet të ketë logot e partnerëve. Kohëzgjatja duhet të jetë 30’’ - max 1 minutë. Video duhet të dorëzohet në HD me CD (2 kopje).

Kualifikimet, Përvoja e kërkuar:

- Eksperiencë e provuar në përgatitjen e Mesazheve/spoteve me natyrë Sociale në Shqipëri në mënyrë të ndjeshme dhe etike (Duhet të sigurohen linket e videos / spoteve / rasteve / dokumentarëve);
- Njohuri për gjendjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri;
- Aftësi e provuar për të përmbushur afatet dhe për të punuar nën presion;
- Fleksibiliteti në përgjigjen ndaj nevojave të agjencisë kontraktuese. Kualifikimi ose eksperiencia që kërkohet.
- Preferohen aplikime nga ekspert/kompani të cilët e ushtrojnë aktivitetin në qytetin e Tiranës dhe/ose Lezhës.

Paraqitja e aplikimit: Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin një letër interesi dhe CV-në e tyre profesionale PDF ose MS Word (në një postë të vetme) si dhe punime të mëparshme të të njëjtit lloj (link ose cd me materialet) në : info@helphelife.org.al deri në ditën e mbylljes së thirrjes, 15 Dhjetor, 2022, ora 16:00. Ju lutemi sigurohuni që subjekti i aplikimit të përfshij titullin e thirrjes për të cilën aplikohet. Aty ku është e mundur, në aplikimet e tyre kandidatët duhet të paraqesin dëshmi të një pune të mëparshme siç përcaktohet në këto Terma Reference. Në rastet e aplikimit të një kompanie duhet të paraqitni edhe NIPT/Ekstrakt QKR.

Përzgjedhja e individit do të bazohet në:

- Sa mirë aplikimi plotëson kërkesat e përcaktuara në Termat e Referencës.
- Përvojë relevante

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen.

Aplikantët gjithashtu mund të dorëzojnë aplikimet e tyre në kopje fizike në adresën e mëposhtme: **Shoqata Ndihamoni Jetën,**

Fshati Prush, Njësia Administrative Vaqarr, Tiranë.

Tel: +35544803370

Website: www.helphelife.org